



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura VIII**

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,  
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen  
e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 117

Prishtinë, më 17.9.2024, në ora 13:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-204

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Adnan Rrustemi, Arijeta Rexhepi, Artan Abrashi, Blerta Deliu- Kodra, Dimal Basha, Driton Selmanaj, Erxhan Galushi, Hajdar Beqa, Hydajet Hyseni-Kaloshi.

**Munguan:** Besnik Tahiri.

**Mbledhjen e kryesoi:** Adnan Rrustemi, kryetar i Komisionit.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë:** Sanije Berisha, OSBE; Ridvan Slivova, Telegrafi; Vullnet Bugaqku, KDI; Detrina Alishani, Kuvendi i Kosovës; Diellza Gashi, Ekonomia Online.

**Stafi mbështetës i Komisionit:** Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20.6 dhe 11.7.2024;
3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2024;
4. Miratimi i Raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/L-034;
5. Miratimi i Raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të Kodit nr.06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur;
6. Raport me amendamente për Projektligjin nr. 08/L-276 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjeve të veçanta për krijimin e bazës ligjore për nxjerrjen e akteve nënligjore nga Qeveria dhe ministrat;
7. Raport me amendamente për Projektligjin nr.08/L-283 për harmonizimin e Ligjeve të veçanta me Ligjin nr. 05/L-087 për kundërvajtje;
8. Kërkesë nga u.d. i Kryeprokurorit të Shtetit për iniciimin e procedurave për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale;
9. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari, propozoi të ndryshohet rendi i ditës, të hiqen pika 6 dhe 7. Anëtarët e Komisionit miratuan njëzëri rendin e ditës me ndryshimet e propozuara.

## **2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mbajtura më 20.6 dhe 11.7.2024**

Kryetari, konstatoi se procesverbalet e datës 20.6 dhe 11.7.2024, u miratuan pa vërejtje.

## **3. Miratimi i Raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror 2024**

Kryetari theksoi disa nga punët kryesore të sesionit pranveror të Komisionit për Legjislacion. Ai njoftoi se janë mbajtur 17 mbledhje, gjatë të cilave janë shqyrtuar gjithsej 64 pika. Nga këto, janë analizuar 18 projektligje për bazë juridike dhe kushtetuese. Për më tepër, janë shqyrtuar 7 projektligje, nga të cilat 2 përbëjnë marrëveshje ndërkombëtare, ndërsa 5 projektligje janë ende në procedurë shqyrtimi.

Kryetari gjithashtu njoftoi se janë formuar 10 grupe punuese, të cilat kanë mbajtur takimet e tyre, si dhe 2 punëtori. Numri i amendamenteve të shqyrtuara në cilësinë e Komisionit të përhershëm ka arritur në 552, ndërsa në cilësinë e Komisionit funksional janë shqyrtuar 74 amendamente. Ai përmendi gjithashtu vizitat e realizuara në institucione të caktuara, si në kuadër të grupeve punuese ashtu edhe si pjesë e aktiviteteve të Komisionit.

Hajdar Beqa theksoi se, edhe pse nuk ka mbetur shumë kohë, është një ide e mirë që të përgatitet një plan pune për dy-tre muajt e mbetur të legjislaturës dhe të vazhdohet me aktivitetet e planifikuara.

Driton Selmanaj, në aspektin formal, theksoi se kemi një raport që përshkruan në mënyrë narrative aktivitetet e Komisionit dhe se do ta votojë atë si dokument. Megjithatë, ai shprehu shqetësimin se si komision nuk kanë arritur ta kryejnë punën e tyre ashtu siç duhet. Ai theksoi se mandati i tyre është të shqyrtojnë dhe të analizojnë ligjet për të identifikuar eventualet kolizionale me ligje të tjera dhe për të vlerësuar kushtetutshmërinë e tyre. Ai e quajti këtë rast të parë në historinë e parlamentarizmit ku 10 projektligje, pas miratimit në Kuvend, janë vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si kundërkushtetutesore. Nga këto, 2 ligje kanë qenë nën kompetencën e Komisionit funksional.

Selmanaj vazhdoi duke thënë se tani që jemi në fund të mandatit, prapë do të kemi ligje të rëndësishme për t'u shqyrtuar, sidomos Ligji për Byronë. Ai theksoi nevojën për vëmendje maksimale në mënyrë që të respektohen rendi kushtetues, parimet kushtetuese, dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias, duke nënkuptuar se duhet të kujdesemi që aktet e miratuara nga Kuvendi të mos bien në kundërshtim me Kushtetutën.

Selmanaj sqaroi se nuk ka qenë pjesë e grupeve punuese, jo për mungesë vullneti, por sepse e ka parë kontributin e tij minimal në ato grupe. Ai shprehu se nuk dëshiron të jetë një "noter" i akteve që nuk janë në përputhje me Kushtetutën. Në përfundim, ai theksoi se si shumicë, duhet të kenë vëmendje në këto pak muaj që kanë mbetur.

Kryetari, nga ana e tij, theksoi se ky është një dimension që është diskutuar vazhdimisht, duke theksuar se funksioni i Komisionit për Legjislacion si komision i përhershëm është të trajtojë përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën dhe ligjet e tjera në fuqi.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, Kryetari konstatoi se me 9 vota për, u miratua Raporti i punës së Komisionit për Legjislacion për sesionin pranveror 2024.*

#### **4. Miratimi i Raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit nr. 05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/-L-034**

Kryetari i Komisionit për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit njoftoi se është formuar një grup punues, i cili ka trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejt mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Ky grup punues ka pasur autoritetin për të zhvilluar aktivitetet e nevojshme për të mbledhur informacione dhe të dhëna mbi nivelin e zbatimit të këtij ligji. Në fund, ata do të përgatisin një raport përmbledhës që do të paraqitet para komisionit dhe, natyrisht, para seancës, tha deputeti Rrustemi.

Gjatë hulumtimit, grupi punues është mbështetur nga ekspertiza e NDI-së. Ai gjithashtu arriti të publikojë gjetjet kryesore lidhur me zbatimin e Ligjit për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe Konfiskuar. Deputeti Rrustemi theksoi se do të paraqesin gjetjet dhe, veçanërisht, rekomandimet e tyre para komisionit.

Pas këtij njoftimi, fjalën e mori z. Hydajet Hyseni, kryesues i ekipit punues, i cili paraqiti gjetjet dhe rekomandimet e grupit mbi mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji. Hyseni theksoi se megjithëse janë vonuar, kanë pritur që të ketë më shumë interesim për këtë çështje, por kjo nuk ka ndodhur. Ai vlerësoi se është bërë një punë e mirë për aq sa ishte e mundur dhe se kjo tregon se është krijuar një ligj i mirë, i cili duket se ka përkrahjen e gjithanshme.

Kryetari i Komisionit paraqiti rekomandimet e raportit, i cili sugjeron ndryshime në Ligjin aktual për menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara. Rekomandimet përfshijnë: Të bëhen ndryshime në ligj për të përcaktuar qartë se Agjencia do të funksionalizojë një regjistër elektronik të të dhënave që lidhen me pasuritë e sekuestruara dhe të konfiskuara.

Të krijohet Fondi i Konfiskimit, i cili do të mundësojë që një pjesë e të hyrave nga shitja e pasurive të konfiskuara të përdoren për qëllime shoqërore apo qeveritare.

Të ndryshohet neni 27 i Ligjit aktual për të mundësuar që Agjencia të aplikojë drejtpërsëdrejti në gjykatë për shitjen e pasurive të sekuestruara që amortizohen shpejt ose kur kostot e mirëmbajtjes së tyre janë të larta.

Të organizohen më shumë fushata vetëdijësuese për të ndihmuar institucionet e tjera të kuptojnë më mirë rolin dhe funksionet e Agjencisë.

Të rritet bashkëpunimi ndër-institucional mes institucioneve kompetente që merren me parandalimin e përfitimeve të jashtëligjshme dhe keqpërdorimit të financave publike. Kjo duhet të përfshijë një vëmendje të veçantë për menaxhimin e aseteve të jashtëligjshme që bien në duar të ATK-së apo Doganës së Kosovës, pasi ligjet në fuqi nuk e definojnë qartë rolin e Agjencisë në këto asete.

Gjatë plotësim-ndryshimit të Ligjit, duhet të ketë bashkëpunim edhe me palët që preken nga ligji dhe me organizatat e ndryshme të shoqërisë civile.

Deputeti Adnan Rustemi sqaroi këto gjetje dhe rekomandime në kuadër të mbikëqyrjes së Ligjit.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, miratoi dhe i rekomandoi seancës shqyrtimin dhe miratimin e raportit të mbikëqyrjes së Ligjit nr.05/L-049 për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin 08/L-034.*

## **5. Miratimi Raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur**

**Kryetari** tha se po ashtu Komisioni për Legjislacion ka vendosur që të bëj mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, me qëllim të arritjes së njohurive praktike të disa çështjeve kryesore. Grupi punues, gjatë hulumtimit, është mbështetur gjithashtu nga NDI. Kryetari më pas i dha fjalën deputetit Erxhan Galushi për të paraqitur gjetjet dhe rekomandimet kryesore të raportit.

Erxhan Galushi, si kryesues i grupit për mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Drejtësisë për të Mitur me nr. 06/L-006, i cili u vendos me vendim të Komisionit më 04.04.2024, njoftoi se kanë zhvilluar disa takime drejtpërdrejt me grupin. Këto takime janë mbajtur kryesisht në Ministrinë e Drejtësisë, Gjykatën Themelore në Prishtinë, Prokurorinë Themelore në Prishtinë, Shërbimin Sprovues të Kosovës dhe Shërbimin Korrektues.

Rekomandimet kryesore nga këto takime janë:

Ministrisë së Drejtësisë i rekomandohet që, në rast të plotësimit dhe ndryshimit të Kodit, të adresojë gjetjet nga ky raport, sidomos në aspektin ligjor. Për ato çështje që nuk lidhen me ndryshimet ligjore, duhet të ndërmerren veprimet e nevojshme për t'i adresuar gjetjet e raportit.

Të themelohen programe të qëndrueshme për rehabilitimin dhe ri-integrimin e të miturve.

Të punësohet staf profesional, si punëtorë socialë, psikologë, instruktorë profesionalë dhe këshilltarë. Duhet të sigurohen burime të mjaftueshme njerëzore për të zbatuar programet individuale, rehabilituese dhe ri-integruese, si dhe ato edukative.

Të zhvillohen programe individuale të përshtatura për gjendjen, zhvillimin psikik dhe atë fizik të çdo të mituri, në përputhje me Kodin për Drejtësi për të Mitur. Këto programe duhet të hartohen nga një ekip multidisiplinar, përfshirë punëtorin social, psikologun, zyrtarin sprovues, edukatorin, të miturin, prindërit ose kujdestarët dhe institucione të tjera relevante.

Të monitorohet procesi nga prokuroritë dhe gjykatat gjatë gjithë procedurës, nga fillimi deri në ekzekutimin e masave.

Të zhvillohet një program i ri kurrikular për Akademinë e Drejtësisë, i cili do të përputhet me standardet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian për të drejtat e fëmijëve dhe drejtësinë për të mitur. Ky program duhet të përfshijë teknikat e intervistimit dhe komunikimin miqësor me fëmijët gjatë procedurave gjyqësore.

Të organizohen trajnime sistematike për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të sistemit të drejtësisë për punën me fëmijë, si dhe trajnime lidhur me masat e reja të diversitetit të parapara sipas Kodit për Drejtësi për të Mitur.

Në fund, deputeti Galushi falënderoi të gjithë anëtarët që ndihmuan në hartimin e këtij raporti, si dhe NDI-në për ofrimin e ekspertizës së nevojshme.

**Kryetari**, tha se Komisioni për Legjislacion ka bërë një punë të madhe në mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, diku rreth 80% të ligjeve të monitoruara të kësaj legjislature janë të Komisionit për Legjislacion, dhe është një mekanizëm i mirë i punës parlamentare për të detektuar mungesat e caktuara të ligjeve në fuqi edhe nevojën për përmirësim.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, kryetari konstatoi se Komisioni, me shumicë votash, miratoi dhe i rekomandoi seancës shqyrtimin dhe miratimin e raportit të mbikëqyrjes së zbatimit të Kodit nr. 06/L-006 i Drejtësisë për të Mitur.*

## **6. Kërkesë nga u.d. i Kryeprokurorit të Shtetit për iniciimin e procedurave për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale**

Kryetari njoftoi anëtarët e komisionit se ka pranuar një email nga ushtruesi i detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, i cili ka kërkuar të fillohet procedura për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Prokurorinë Speciale, i cili është miratuar dhe është në fuqi.

Në kolegjin e Prokurorit të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, të mbajtur më 30.08.2024, është trajtuar një kërkesë e pranuar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës për të dhënë një udhëzim në lidhje me rastet kur të dyshuar për vepra penale të korrupsionit janë prokurorët e asaj prokurorie.

Sipas ligjit aktual për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, vetëm Prokuroria Speciale ka kompetencë të veçantë për vepra penale të korrupsionit, pa i përjashtuar as prokurorët e PSRK-së. Të gjithë prokurorët në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit e vlerësojnë si të nevojshme ndryshimin e ligjit, që në rastet kur të dyshuar janë prokurorët e PSRK-së, të caktohet si prokurori kompetente një prokurori tjetër, ose t'i jepet mundësia ligjore Kryeprokurorit të Shtetit që këto raste t'i delegojë në ndonjërin nga prokuroritë e tjera, ose që këto raste t'i marrë në kompetencë Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit.

Arsyeja për këtë ndryshim është se një nga palët që ka paraqitur kallëzim penal ndaj disa prokurorëve të PSRK-së është ankuar kundër aktvendimit për hudhjen e kallëzimit penal nga prokurori që gjithashtu punon në të njëjtën prokurori. Prokuroria e Apelit e ka prishur këtë

aktvendim dhe çështjen e ka kthyer për rivendosje në PSRK, duke i dhënë udhëzime që të konsultohet me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit.

Andaj, me qëllim të zhvillimit efikas të procedurës penale, shmangies së neglizhencës, moszbatimit të ligjit dhe evitimit të çdo konflikti të mundshëm të interesit, konsiderohet urgjente shqyrtimi i kërkesës për ndryshimin e Ligjit të Prokurorisë Speciale, për të shmangur një gjendje të tillë në praktikë.

---

Kryetari njoftoi se ka kthyer një e-mail, duke kërkuar që të sqarohen në mënyrë konkrete cilat janë nenet dhe përmbajtja për të cilat bëhet fjalë. Ai gjithashtu tha se ka pranuar një dokument me disa nene të renditura.

Kryetari theksoi se në raste të tilla, kur institucionet relevante kërkojnë ndihmën e Kuvendit për të përmirësuar punën e tyre, është e rëndësishme që kjo të trajtohet me efikasitet. Ai propozoi themelimin e një grupi punues prej tre deputetësh, të cilët do të ulen bashkë dhe, mundësisht, të kenë një takim me Kryeprokurorin e Shtetit (ushtuesin e detyrës së Kryeprokurorit). Qëllimi do të ishte adresimi i plotësimin dhe ndryshimit të Ligjit, ndërsa kërkoi nga administrata që të angazhojë një nga këshilltarët juridik për të ndihmuar në aspektin formal, duke përfshirë hartimin e memorandumit dhe procedurave të tjera në rast të inicimit të ndryshimeve ligjore.

Deputeti Hajdar Beqa, në lidhje me nismën e ushtuesit të detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, theksoi se duhet formuar një grup punues që do të dëgjojë palët e interesit, Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe prokurorët e tjerë. Ai nënvizoi se çështja është sensitive, sepse Prokuroria, kur ka të bëjë me prokurorët e saj, e delegon lëndën, duke u shprehur se nuk mund të bëhen hetime mbi një prokuror në vendin ku ai punon.

Megjithatë, Beqa theksoi se kjo qeveri është në fund të mandatit dhe, për shkak të kohës së shkurtër, ndoshta kjo detyrë do t'i mbetet Qeverisë së re dhe ndoshta Kryeprokurorit të ri.

Kryetari theksoi se, nëse ka pajtueshmëri dhe arsyeshmëria e kërkesës qëndron, ajo çfarë kërkohet është shndërrimi i saj në dispozita formale të projektligjit. Ai theksoi se është domosdoshmëri të hartohet një memorandum shpjegues, që të përfshijë dy referenca: përputhshmërinë me koston financiare dhe përputhshmërinë me të drejtën europiane. Memorandumi do të dërgohet në Qeveri për mendim, e cila ka 30 ditë për të kthyer përgjigje. Kryetari shprehu shpresën që opinioni të kthehet brenda javës, në mënyrë që të mund të propozojmë miratimin e tij me procedura të përshpejtuara brenda një seance, me dy lexime, duke theksuar se bëhet fjalë për një proces të thjeshtë. Ai gjithashtu sugjeroi themelimin e një grupi punues dhe organizimin e një takimi me Kryeprokurorin për sqarime shtesë rreth propozimit.

Deputeti Driton Selmanaj u shpreh se kanë të drejtë të nisin procedurat për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit. Ai sugjeroi që të dakordohen për fillimin e këtyre procedurave, të cilat duhet të kalojnë në Kryesi për miratim. Pas miratimit nga Kryesia, do të mund të fillojnë punën grupi punues. Selmanaj theksoi se sot mund të vendosin vetëm për fillimin e procedurave të kësaj nisme.

Kryetari shprehu dakordësinë e tij, por dëshiroi të sqarojë se nuk sheh nevojën për miratim në Kryesi. Ai theksoi se ka të drejtë të propozojë një projektligj në Kuvend, Presidenti, Qeveria, një deputet, i cili duhet të përkrahet nga të paktën 5 deputetë (referuar pikës 1.3, neni 70, Rregullorja e Kuvendit).

Sipas nënparagrafëve 1, 3 dhe 4 të këtij neni, projektligji i propozuar, së bashku me shkresat e kërkuara në nenin 71 të rregullores, i dërgohet Qeverisë për mendim, përmes Kryetarit të Kuvendit. Qeveria duhet të paraqesë mendimin e saj me shkrim, të nënshkruar nga Kryeministri, brenda një afati prej 30 ditësh.

Pas kalimit të këtij afati, projektligji mund të procedohet në Kuvend. Kështu, duhet të hartohet ndryshimi, të përgatitet memorandumi, dhe të mblidhen dy shkresa në Kuvend, të cilat do t'i dërgohen Kryesisë. Kryesia, sipas Kryetarit, vetëm formalitet, e dërgon në Qeveri dhe nuk ka të drejtë ta ndalojë ose ta hedhë poshtë; vendimi për këtë bie vetëm në kompetencën e seancës së Kuvendit.

Pas marrjes së opinionit nga Qeveria, qoftë pajtues apo mospajtues, do të formohet grupi punues për të vazhduar me procesin e ndryshimit të ligjit. Kryetari gjithashtu kërkoi angazhimin e një këshilltari ligjor për ta shndërruar këtë ndryshim në projektligj.

**Dimal Basha** propozoi që sipas nevojës të takohen me ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit që të flasin konkretisht për çështjen.

**Kryetari** do flasë me këshilltarët juridikë për punën teknike, draftin në tri gjuhë, në tri kolona, memorandumimin shpjegues, dy shkresat e nevojshme, dhe javën e ardhshme mund ta takojmë ushtruesin e detyrës së Kryeprokurorit i gjithë Komisioni në një takim jo formal që të diskutojmë për këtë çështje.

*Meqë nuk pati diskutime tjera, Adnan Rustemi me përkrahjen edhe të tetë deputetëve tjerë, morën Nismën Legjislative për plotësim ndryshimin e Ligjit nr. 08/L-168 për Prokurorinë Speciale*

## 7. Të ndryshme

**Dimal Basha**, theksoi se në lidhje me Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, duhet përfunduar mbikëqyrja e ligjit, mirëpo, duhet të dakordohemi që në vizita të vijmë më shumë deputetë sepse nuk mund të shkohet vetëm dy deputetë.

**Driton Selmanaj** tha se çështja e Shërbimit Korrektues është bërë problem medial dhe mendon se humb serioziteti të vizitohet burgu i Dubravës nga vetëm ai dhe një deputet tjetër. Kurdo që vendosim, duhet t'i njoftojmë ata se ne kemi interes përtej takimit formal me ta, duhet të vizitojmë disa prej pavijoneve, kuzhinën dhe kushtet shtoi ai.

Mbledhja përfundoi në orën 14:00.

E përgatiti:  
Stafi mbështetës i Komisionit.

**Adnan Rrustemi,**  
Kryetar i Komisionit

-----